


VITI XIV, NUMRI 6 / QERSHOR 2010

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SLOVENIA



REX &
AIDAN

in Budapest



Tani afër morra pjesë në Rallyn e Amerikës Latine në Rio de Janeiro. Ishte një sukses fantastik. Distributorësh më të mirë të botës u takuan me publikun prej dymbëdhjetë mijë distributorët të Amerikës latine për shtatë ditë me radhë. Pika kulminante e udhëtimit ishte kur u ngjitëm në Sugarloaf Mountain (Mali Bukësheqeri), i cili ngrihet nga derdhja e Guanabara-s në lartësinë 400 metra mbi portin. Prej aty shihet një panoramë e paparë, dhe ky ishte një moment i paharueshëm për të gjithë ata që e shijuan këtë mrekulli.

Në këtë Rally me të vërtetë të suksesshëm kurorëzuam fituesen e këtij viti, Miss Sonyën e re të Amerikës Latine, Fabiola Pina-n. Falë kësaj Fabiola ka nderin të udhëtoj me ne në Super Rally në Denver, ku do të përfaqësoj rajonin e Amerikës Latine. Bashkë me të vijnë edhe fitueset e katër rajoneve të tjera me të cilat konkuron për kurorën e Miss Sonya 2010.

Publikut të Rios i tregova një histori të mrekullueshme të cilën mendova ta ndaj me të gjithë ju sepse më duket shumë prekëse dhe na bën të mendohemi. Jo shumë kohë më parë lexova një libër: novelën me titull „Alkimisti” të Paulo Coelho. Jam i sugurt që shumë prej jush e kanë lexuar. Novela hyri edhe në librin e Rekordeve Guinness! Është përkthyer në 53 gjuhë të ndryshme, kurse në Brazil u bë libri më i shitur i të gjitha kohërave. Kjo histori bën fjalë rreth një djali bari nga Andaluzia me emrin Santiago, i cili nga një shtytje e brendshme nis të kërkojë një jetë më të plotë. Për këtë duhet t'ia dorëzojë vetveten një të panjohuri dhe të ndjekë atë që i dikton zemra, me shpresën se do e

The Thesaurist

I BRENDSHËM

gjeg fatin e tij. Në këtë histori të gjithë ne udhëtojmë bashkë me Santiagon, dhe kuptojmë që thesari, pasuria që kërkojmë mund të na vijë në jetë në forma të ndryshme.

Thelbi i gjithë librit është: detyrimi i njeriut për të plotësuar fatin e tij. Nëse e dëshiron me të vërtetë diçka, gjithë universi kontribuon, të ndihmon ta arrish pikësynimin tënd.

Sipas meje kjo histori është e vërtetë për secilin prej nesh, që i përkasim FOREVER-it. Nga një bari nuk presin gjëra të mëdha. Tregëtar endacak, i cili endet sa andej-këtej duke u kujdesur për kopenë. I shërben klientët me mish dhe lesh. A nuk ishim të gjithë të tillë para se të gjenim FOREVER-in?

Santiago ishte dhe dëshironte të ishte ndryshe nga të tjerët. Lexoi libra interesant. Ëndërronte për vende ekzotike. E dinte që bota përmbante për të më shumë se sa pritet nga jeta e një bariu të thjeshtë. Kishte një ëndërr konstante që diku në Egjipt, në rrëzë të piramidave kishin fshehur një thesari të madh i cili priste atë që ta gjeg. Thesari përmbente një shtytje të brendshme aq të madhe saqë mposhti edhe frikën që mund të humbas gjithçka që kishte arritur deri tani. Të duket diçka

e njohur?

Djali morri ndihmë në vendet më të papritura dhe nga njerëzit më të veçantë. Në fund të rrugës plot me rreziqe Santiago gjatë kërkimit të të mirave të botës e gjeti thesarin – në brendësi.

Kjo histori bën fjalë rreth besimit, forcës dhe guximit, të cilat i zotërojmë edhe ne, dhe na bëjnë të aftë të kërkojmë arritjen edhe të ëndrrave tona më të ndërlikuara. Santiago na tregon se si duhet të kemi besim në vetvetë, si duhet të lexojmë dhe të kuptojmë gjatë rrugës sonë shenjat e komplikuar të cilat na ndihmojnë të arrijmë ëndrrat tona.

Ti ku ndodhesh në rrugën tënde? Çuditësh që hyre në FOREVER? E ke gjetur thesarin tënd? Këto të mira i ke gjetur në botë apo në vetvetë? I ke ndihmuar ata që ke takuar gjatë rrugës? U tregove guximtar kur duhet të përballohesh me vështirësitë? U tregove modest kur festove rezultatet dhe fitoret e tua? Ndodhesh në fund të rrugës tënde, apo je akoma në fillim të kërkimit të thesarit? Është nder i madh për mua që jam pjesë e rrugës tënde, që udhëtojmë së bashku. Mos lejo që të të thyejnë, „rrugët shmangëse” janë rrugë qorre! Mba gjithmonë parasysh pikësynimin. Mos lejo në asnjë moment që të zbehet pamja gjatë rrugës tënde. Tregohu i duruar dhe kushtoj gjithmonë vëmendje detajeve të cilat shpeshherë na tregojnë rrugën në labirint. Ki parasysh atë që alkimisti i thotë Santiagos: „Sekreti ndodhet këtu në të tashmen. Po t'i kushtosh vëmendje të sotmes, mund të zhvillohesh. Dhe nëse mund të zhvillohesh sot, ajo që vjen nesër është gjithmonë më e mirë.”


REX MAUGHAN





MREKULLI E VOGËL

Më në fund erdhi momenti i shumëpritur! Na vizitoi drejtori i përgjithshëm i FLP International **Rex Maughan**, dhe drejtori i Europës **Aidan O'Hare**, nga të cilët mësuam shumë se si mund të ndërtojmë thjeshtë, pastër dhe me profesionizëm një biznes të madh, biznesin e Forever-it, me të cilin mund të ndryshojmë të ardhmen e qindra mijëra familjeve në një drejtim të favorshëm për to. I falenderojmë që me praninë e tyre na nderuan në festën e përvjetorit të 13-të të firmës sonë.

Është kënaqësi për ne që jemi të parët në Europë që nisim sistemin e ri të komunikimit celular, i cili është i vetmi në gjithë botën, dhe na ofron mundësitë e komunikimit të shekullit XXI. Çfarë përparesish ka hyrja në sistemin **Forever Telefon**? Në radhë të parë duhet të themi që nuk është mjet i ndërtimit të rrjetit, por do të jetë një ndihmë e domosdoshme e punës së rrjetndërtuesve që punojnë në sistem – madje është për ata që tashmë e përdorin. Njëpër një për çdo rrjetndërtues (nga niveli i asistent supervisorit) mund të marrë menjëherë informacione, dhe gjithë këtë mund ta bëjë me tarifa shumë të favorshme. Për të gjithë është e rëndësishme që të marrin informacione nga dora e parë, nga qendra amerikane dhe ajo e Budapestit. Sa shumë gjëra mund të arrihen nga qendra amerikane vetëm me shtypjen e një butoni brenda 24 orësh? Informacionet më të rëndësishme në lidhje me produktet, blerjet, uljet e çmimeve, shitjet, nxjerrjen në treg të produkteve të reja, rezultatet e procedurave speciale të lishensimit, apo njohja e zbulimeve shkencore më të reja. Mund të sigurojmë menjëherë çdo informacion rreth ndryshimeve të mundshme të sistemit tonë marketing, nisjes së programeve të reja motivuese, ndryshimeve të kriterëve dhe gjithçka rreth datave dhe vendeve të organizimit të aktiviteteve tona që ndohmojnë ndërtimin e rrjetit. Sistemi na siguron mundësinë e leximit të menjëhershëm të pikëve, kurse për drejtuesit bën të mundur përcjelljen e informacioneve për linjat e poshtme. Krahas gjithë këtyre na jepet mundësia e porositjes së produkteve nga celulari kudo të jemi, në Miskolc, Pecs apo Novisad. Natyrisht kujdesemi edhe që kur punonjësit tanë dëshirojnë të pushojnë dhe të udhëtojnë, të gjejnë mundësitë më të favorshme të blerjes së biletave të avionit. Për ata që dëshirojnë të mësojnë me ndihmën e Forever Telefon mund të shihet edhe transmetimi prej 24 orësh i Forever TV. Pra, që tani kemi në dorë një mjet të vogël, por me informacione të shumta – siç e thashë të parët në Europë – dhe me këtë mjet të ri që ndihmon efektivitetin e ndërtimit të biznesit na jepet mundësia që të bëjmë një qarkullim edhe më të madh, dhe të ndihmojmë edhe më shumë njerëz që ta shijojnë jetën me më shumë shëndet dhe mirëqenie.

Përpara FLP Hungari!

DR. SANDOR MILESZ
DREJTOR GJENERAL



BEOGRAD, SERBIA

Success Day

Ditët e para të stinës së re na dhanë forca të reja për punë, sepse jemi të sigurt që na pret një vit i pasur në suksese.

Senior menaxherët **Sonja** dhe **Nebojša Knežević** drejtuan aktivitetin e parë të pranverës ku u paraqitën punonjësit më të suksesshëm të Forever Living Products. **Çifti Knežević** e pa që në fillim mundësinë e ndritshme të të ardhmes tek FLP-ja, kurse rezultatet e tyre të shkëlqyera janë dëshmi e shkëlqyer e faktit që morrën vendimin e duhur disa vite më parë.

Në fillim të Ditës së Suksesit të pranishmit u përshëndetën nga drejtori rajonal i zyrës së Beogradit **Branislav Rajić**. Përsëriti shkurt rezultatet e shkëlqyera të punës të shpallura në Rallyn European të Londrës, si dhe u dha të pranishmëve informacione dhe udhëzime të reja për punën e tyre. FLP është një nga firmat më të besueshme të tregut serb, kurse ndërtimi i marrdhënieve brenda firmës përbën një fitore të madhe për të gjithë.



Ljiljana Stjepanović, artistja e teatrit *Pozorište na Terazijama* – e cila është konsumatore e kënaqur e produkteve tona dhe mike e ngushtë e firmës sonë – luan prej tridhjetë e pesë vitesh në skenë dhe filma gjithashtu. Talentin e saj e ka vërtetuar në shumë filma, seriale dhe shfaqje kabare në vend. Me këtë rast repertori i saj i pasur na magjepsi të gjithë. E falenderojmë për shfaqjen e saj të paharrueshme, dhe shpresojmë që mbetet akoma konsumatorja jonë dhe na respekton edhe në të ardhmen në aktivitetet tona.

FLP përpiqet gjithmonë që të jetë e kohës, që me produktet e reja cilësore (të cilat shkaktojnë një interesim të madh kudo në botë) të jetë gjithmonë një hap përpara firmave konkurente. Menaxherja **Siniša Blašković** dhe mjeshterja e kozmetikës së firmës sonë Dragana Nikolić prezantuan në mënyrë të shkëlqyer paletën e gjerë të produkteve të reja që tashmë ndodhen në qarkullim. Shpresojmë që edhe këto produkte ta gjejnë shpejt rrugën drejt konsumatorit, dhe që blerësit tanë të jenë edhe në të ardhmen të kënaqur me produktet e firmës sonë.

Me mënyrë jetese dhe ushqimim të kujdesshëm mund të shmangim shumë probleme të përditshme. Produktet tona me vlera të pasura ushqyese dhe cilësi të kontrolluar ofrojnë një ndihmë të shkëlqyer, na e lehtësojnë jetën. Rreth këtyre foli lektori ynë i shkëlqyer **Dr. Bora Vujasin** i cili e pëlqen shumë firmën Forever.

Prezantimi i përvojave me produkte të konsumatorëve dhe mjekëve është një nga pikat më të rëndësishme të gjithë aktiviteteve tona. Në këtë kohë na jepet mundësia të dëgjojmë një vlerësim të sinqertë dhe bindës rreth produkteve tona me cilësi të shkëlqyer. Falenderojmë **Dr. Snežana Kontra** për drejtimin e shkëlqyer të kësaj pjese të programit.





Pas kësaj në skenë përshëndetëm supervizorët dhe anëtarët e Klubit të Sundimtarëve, si dhe punonjësit tanë që gjatë periudhës së kaluar e ndërtuan me shumë përkushtim dhe sukses rrjetin e tyre të konsumatorëve dhe punonjësve. I përgëzojmë të gjithë dhe u urojmë suksese të shumta në punën e tyre.

„Gjatë gjithë jetës sime jam përpjekur të bëhem më e mirë” – filloi leksionin e saj soaring menaxherja **Vesna Kuzmanović**. „Kjo më nxiti të luftoj, dhe bashkë me burrin tim vendosëm: do ndërtojmë rrjet punonjësish në radhët e Forever-it. Vetëm procesin e lindjes dhe vdekjes sonë nuk e ndryshojmë dot, gjithçka tjetër varet vetëm nga ne, nga vendimet dhe veprimet tona të duhura. Dëshironim të jetonim dhe të punonim ndryshe, dhe donim ta shijonim të gjithë këtë. Me ndihmën e FLP-s i realizuam imagjinatat tona! E falenderojmë firmën tonë që na tregoi se si mund të punojmë për një jetë më cilësore!”

„Jo vetëm ëndërroni, por edhe realizojini ëndrrat tuaja, dhe merrni përgjegjësinë për të ndihmuar të tjerët në realizimin e ëndrrave të tyre!” – këshilloi në leksionin e tij menaxheri **Dr. Aleksandar Petrović**. „Pjesët më të mira të jetës nuk i marrim falas, duhet t’u kushtojmë kohë atyre, e cila shpeshherë na shpërblehet. Ai që fillon të punoj në radhët e FLP-s, e bën atë gjithmonë në momentin më të përshtatshëm! Zgjidhja më e mirë fshihet në biznesin privat, sepse na siguron burime të qëndrueshme të ardhurash dhe me këtë një pavarësi me afat të gjatë kohe.”



„FLP është mundësia më e mirë e punës, sepse ofron pavarësi të plotë në jetë dhe punë gjithashtu, kudo që jeni.” tha në leksionin e saj safir menaxherja **Daniela Ocokoljić**. „Qëndrueshmëria, parimi, produktet cilësore, mënyra e shitjes dhe produkti më i mirë i Forever-it – plani marketing – ofron një siguri të madhe. Puna, familja, fëmijët e vegjël, karriera, udhëtimet e mia... janë të gjitha në harmoni! E falenderoj Rex-in për këtë mundësi të mrekullueshme! Varet vetëm nga ne që a e shfrytëzojmë këtë në mënyrën më të mirë të mundshme.”

Përdorimi i produkteve FLP në kuzhinë ka filluar kohë më parë. Na krijohen mundësi të mëdha nëse i përdorim edhe këto produkte në përgatitjen e ushqimit tonë të përditshëm. Përdorimi i disa ushqimeve të përditshme në kokteile dhe salca krijojnë dimensione krejt të reja. E falenderojmë kuzhinierin profesionist dhe përdoruesin besnik prej shumë viteve të produkteve tona, **Dragan Lukić** për prezantimin e shkëlqyer, gjatë të cilit tregoi një pikëpamje krejt të re të përgatitjes së ushqimeve të përditshme.

Si përfundim asistent supervizorët morrën medaljet e tyre të merituar dhe u uruam atyre karrierë të suksesshme në radhët e firmës sonë.

Branislav Rajić,
drejtori rajonal i FLP Serbisë

Aktivitetin e ardhshëm Dita e Suksessit e organizojmë më 29 maj 2010 në orën 11. Para këtij më 22 maj marrim pjesë në takimim e manaxherëve në Szirak dhe më 23 maj në Ditën e Suksessit të Budapestit







RALLY EUROPIAN

AUSTRI, VIENË

15-16 PRILL 2011

Periudha e kualifikimit: 1 korrik deri në 31 tetor

NIVELI 3

Plotësoni 95 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ 3 NETË NË HOTEL
- ★ UDHËTIMI ME AVION



NIVELI 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ 3 NETË NË HOTEL



NIVELI 1

Plotësoni 20 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ BILETA HYRJE NË RALLY



Kushtet e reja të kualifikimit për në çdo nivel: Sponsorizoni të paktën tre distributor të gjeneratës së parë të cilët arrijnë nivelin e Assistant Supervisorit. Çdo distributor i ri duhet të arrijë vlerat e pikëve të dhëna në figurë.

I kualifikuari të jetë "Aktiv" në çdo muaj të periudhës së kualifikimit. Periudha e kualifikimit zgjat nga 1 korrik 2010 deri më 31 tetor 2010, gjatë kësaj periudhe duhen plotësuar gjithë kushtet e kualifikimit. Distributorët e rinj duhen regjistruar gjatë periudhës së kualifikimit, dhe ndërmjet tyre ai që dëshiron të kualifikohet duhet të jetë aktiv që në muajin e hyrjes. Data e hyrjes është ajo e regjistrimit të të dhënave të tij në sistemin kompjuterik të kompanisë qëndrore. Në këtë program motivues kanë vlerë vetëm blerjet e bëra brenda rajonit. Çdo distributor i linjës së poshtme duhet të zotërojë adresë brenda rajonit. Çdo distributor mban përgjegjësi për kuptimin e duhur të kushteve të programit motivues. S'ekziston mundësia e trajtimit të veçantë. Programi motivues përmban vetëm kushtet dhe shpërblimet e shfaqura në figurë. Për çdo pyetje që keni drejtohuni drejtorit tuaj gjeneral. Shpërblimet nuk mund të shkëmbehen në para dhe shpërblimet nuk mund t'u jepen të tjerëve.

NDRYSHIM I NDP-S

Distributori që sponsorizohet prej gjashtë muajve dhe nuk e ka arritur akoma nivelin e Asistent Supervizorit ka të dejtë të zgjedh sponsor të ri.

Distributorët që zgjedhin sponsor të ri i humbasin të gjitha linjat e poshtme dhe pikët e kreditit të mbledhura deri atë moment, dhe konsiderohen si të sponsorizuar të rinj në çdo program motivues ku marrin pjesë.

Ky ndryshim vjen në fuqi nga data 1 nëntor 2010. Deri në këtë datë çdo distributor ka mundësi edhe pesë muaj që të ndihmoj distributorët e linjës së poshtme që të arrijnë nivelin e Asistent Supervizorit para se të vij në fuqi ky rregull.

Jemi të sigurt që këto rregulla i ndihmojnë gjithë punonjësit tanë të dashur që ta ngrënë akoma më lart biznesin Forever. Ju lutem që këto ndryshime t'ua bëni të ditur gjithë kolegëve tuaj. Është shumë e rëndësishme që t'ua shpjegoni atyre këto rregulla të reja.

Me respekt:
DR. SANDOR MILESZ
Drejtore gjeneral



Bëhu edhe ti EAGLE MENAXHER!

Për të arritur statutin Eagle Menaxher – pasi keni arritur nivelin e Menaxherit të Vlerësuar – në çdo vit duhet të kualifikoheni duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

Kandidati...

1. Të jetë aktiv dhe të kualifikohet çdo muaj për bonueset e menaxherit.
2. Të mbledh të paktën 720 pikë krediti totale, ndërmjet të cilave 100 pikë të jenë pikët e distributorëve të rinj të sponsorizuar.
3. Të sponsorizoj të paktën dy distributor të rinj të cilët arrijnë nivelin e supervizorit.
4. Të mbështes aktivitetet vendase dhe rajonale.

Kushtet e këtij programi motivues në vitin e parë – i cili fillon nga 1 qershor 2010 – janë radhitur mëposhtë:

1. Të jetë aktiv dhe të kualifikohet çdo muaj për bonueset e menaxherit në çdo muaj nga qershori deri në dhjetor.
2. Të mbledh të paktën 420 pikë krediti totale, ndërmjet të cilave 60 pikë të jenë pikët e distributorëve të rinj të sponsorizuar.
3. Të sponsorizoj të paktën dy distributor të rinj të cilët arrijnë nivelin e supervizorit.
4. Të mbështes aktivitetet vendase dhe rajonale nga qershori deri në dhjetor.

Përveç kushteve të mësipërme Senior Menaxherët dhe Menaxherët Drejtues që ndodhet mbi këtë nivel duhet të mbështesin dhe të zhvillojnë Eagle Menaxherët e linjës së tyre të poshtme në mënyrë që edhe ata vetë të kualifikohen si Eagle Menaxher (detajet shikojini në tabelën e mëposhtme). Çdo Eagle Menaxher i linjës së mëposhtme duhet të jenë prej linjave të ndryshme sponsorizuese, dhe mund t'i përkas çdo lloji gjenerate.

- a. Senior Menaxher: 1 Eagle Menaxher i linjës së poshtme
- b. Safir Menaxher: 6 Eagle Menaxher të linjës së poshtme
- d. Diamant-Safir Menaxher: 10 Eagle Menaxher të linjës së poshtme
- e. Diamant Menaxher: 15 Eagle Menaxher të linjës së poshtme
- f. Diamant Menaxher i Dyfishtë: 25 Eagle Menaxher të linjës së poshtme
- g. Diamant Menaxher i Trefishtë: 35 Eagle Menaxher të linjës së poshtme
- h. Diamant Centurio Menaxher: 45 Eagle Menaxher të linjës së poshtme

Mëtej:

- Për Senior Menaxherët dhe punonjësit që ndodhen mbi këtë nivel kushti është që në linjën e tyre të mëposhtme duhet të ketë aq Eagle Menaxherë sa i përket nivelit të Menaxherit ku punonjësi në fjalë ndodhet në fillim të vitit. Përshembull nëse ky punonjës e fillon vitin si Safir Menaxher dhe gjatë vitit bëhet Diamant Safir Menaxher, ai duhet të plotësoj kushtet e Eagle Menaxherit që i përkasin Safir Menaxherit, pavarësisht se gjatë vitit arriti nivelin e Diamant Safir Menaxherit.

- Në aspektin e plotësimit të kushteve llogariten edhe Eagle Menaxherët e linjave të poshtme nga shtetet e huaja.

- Përsa i përket plotësimit të 100 pikëve të reja të kreditit Menaxheri në fjalë mund të llogaris edhe pikët e kreditit të distributorët të rinj të sponsorizuar që vijnë nga shtete të huaja.

Eagle Menaxherët kualifikohen dhe fitojnë një udhëtim për në Rallyn Rajonal. Kjo përfshin biletat e avionit dhe fjetjen për tre netë (pa ushqim) për dy persona.

Ky është një rregull i ri dhe vlerësim shumë interesant.

Perioda e kualifikimit fillon më 1 qershor 2010.

TË BËHET ÇDO MENAXHER EAGLE MENAXHER!

U uroj të gjithëve suksese të shumta!

LUBJANA, SLOVENIA

Success Day



Na përshëndeti një ditë e mrekullueshme pranvere në mëngjesin e aktivitetit tonë Success Day të Lubjanës. Drejtuesja e programit ishte menaxherja Slavica Božnik e cila na udhëhoqi me zotësi deri në fund të aktivitetit.



Drejtori i rajonit **Andrej Kepe** pasi na përcolli urimet e drejtorit gjeneral **Dr. Sandor Mílesz**, na bëri të njohur të rejat e firmës, si programin Holiday Rally, produktet e reja dhe gjithë gjërat me të cilat Forever Living Products na kënaq dhe nëpërmjet të cilave përmirëson kushtet e ndërtimit të biznesit. Puna jonë krijon një komunitet – ky fakt u përforcua nga humoristi dhe konsumatori i kënaqur i produkteve tona, **Vinko Šimek**, i cili gjatë shfaqjes së tij argëtuese tha se produktet e mbushin me forca dhe kënaqësi.



Menaxherja **Ksenja Batista** foli rreth dëshmimeve kosher dhe islamike të sigurura nga firma jonë, pastaj bëri të njohur sistemet e sigurimit të cilësisë të përdorura rregullisht tek ne. E falenderojmë Ksenjan për leksionin e saj tepër interesant.

Lektori i mëpasshëm ishte senior menaxheri **Tomo Brumec**, i cili pikërisht përpara Ditës së Suksesit u kthye nga Rio de Janeiro i Brazilit, ku udhëtoi bashkë me gruan e tij **Andrea** dhe distributorët më të suksesshëm të botës. S'kemi për t'i harruar kurrë filmimet, plazhet, hotelet dhe natyrën e mrekullueshme. Jemi të sigurt që ishte një udhëtim fantastik. Kushdo mund ta arrijë atë që arriti Tomo dhe Andrea. Kushdo prej nesh mund ta marrë rrugën dhe mund të udhëtoj me distributorët më të suksesshëm të botës. Forever siguron programet motivuese më të mira dhe e shpërblen mirë punën e kryer. Ta shfrytëzojmë mundësinë dhe do të kemi sukses! Faleminderit Tomo dhe Andrea që nëpërmjet syve tuaj edhe ne e pamë Rio de Janeiron.

Leksioni i mëpasshëm kishte titullin „MLM është punë e vështirë”. Menaxheri Andrej Kepe bëri të njohur përparësitë e biznesit MLM, dhe foli rreth faktit se e rëndësishme është ta kryejmë me kënaqësi këtë punë nga e cila marrim shumë të mira. Në radhë të parë mundësinë e suksesit: s'duhet të bëjmë gjë tjetër, veçse ta shfrytëzojmë atë dhe të takojmë „turbo start”!

Andrej Kepe na parapërgatiti bukur për leksionin e senior menaxheres **Rinalda Iskra**. E kemi dëgjuar shpeshherë pyetjen që përse është mirë tek ne? Rinalda e shpjegoi thjeshtë dhe qartë këtë. E falenderojmë për leksionin e shkëlqyer, e falenderojmë Rinaldën që bindi aq shumë njerëz rreth faktit që sa e mrekullueshme është jeta e Forever-it.

Erdhi koha të vlerësojmë të gjithë ata që u ngjitën në një shkallë më të lartë në sistemin e kualifikimeve, si dhe të vlerësojmë punën e distributorëve më të suksesshëm dhe anëtarëve të Klubit të Sundimtarëve.

I përgëzoj të gjithë nga zemra dhe shpresoj që në aktivitetin e ardhshëm Dita e Suksesit t'ju shikoj përsëri në skenë dhe t'ju dorëzoj shiritet që ju takojnë për punën e palodhshme!

Kualifikimet dhanë një ritëm të ri, pas kësaj e shijua shumë shfaqjen e **Stane Vidmar**, i cili me zërin e tij të mrekullueshëm na shkaktoi një surprizë jo të vogël.





E dëgjojmë shpeshherë që sa rol të rëndësishëm luan sporti në jetën tonë. Menaxherja **Jasminka Petrovič** në leksionin e saj foli rreth asaj që duhet të bëjmë në mënyrë që organizmi ynë ta duroj më mirë ngarkesën që shkakton sporti. Forever Freedom dhe Forever Active HA bashkë me produktet e tjera janë mjete të domosdoshme në jetën e çdo sportisti. E falenderojmë Jasminkën për leksionin e saj të hollësishëm dhe të këndshëm! Më kujtohet akoma dita kur në sallë u dëgjua kënga teksti i të cilës ishte pak a shumë kështu: „ai është doktori më simpatik...”, dhe të gjithë e morrën vesh që në skenë mbërrin kolegu ynë prej shumë vitesh, senior menaxheri **Dr. Miran Arbeiter**. Në leksionin e tij me titull „Produktet e FLP-s dhe sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut” Dr. Miran Arbeiter na dha shumë këshilla të mira, kurse ne i ndjekim me kënaqësi udhëzimet e tij. E falenderojmë Miranin për punën e kryer në lidhje me Ditën e Suksesit, si dhe për ndihmën që na ofron pothuajse çdo ditë. I urojmë suksese të mëtejshme në rrugën e Forever-it.





Dalëngadalë po afrohej fundi i Success Day-t, por kishin mbetur prapa përvojat me produkte që kanë vlerë të paçmueshme. Kjo pjesë e programit u drejtua nga menaxherja **Danica Bigec**. Me Danicën në skenë u ngjiten ata që treguan përvojat e tyre pozitive në lidhje me produktet Forever. E falenderojmë Danica Bigec-in për punën dhe mundimin e saj. Falenderuam gjithashtu menaxheren **Slavica Božnik** e cila e tregoi veten si një drejtuese e shkëlqyer programi. Dhe erdhi fundi i kësaj dite të mrekullueshme. U mbusha plot me krenari kur pashë punonjësit që u radhitën në skenë, të cilët e meritonin medaljen e parë me shqiponjë. Ndiqeni edhe ju vizionin Forever që Rex Maughan krijoi për ne. Dhe shikoni lart, sepse në majë ka vend për të gjithë.

Andrej Kepe
drejtor rajonal


Takohemi përsëri më 27 nëntor në aktivitetin e ardhshëm Success Day të Lubjanës!



Udhëtim i shkëlqyer

**ËSHTË NJË NDJENJË E
MREKULLUESHME TË
PËRJETOSH WORLD
RALLYN NË SHOQËRINË E
DREJTORËVE GJENERAL
DHE MENAXHERËVE
MË TË SUKSESSHËM
TË BOTËS. AQ E
MREKULLUESHME SAQË
BASHKË ME GRUAN
TIME ANDREA HAPËM
MENJËHERË VELËN!**

Miqtë tanë na shikojnë gjithmonë në mënyrë të çuditshme kur tregojmë rreth udhëtimeve dhe organizimit, mendojnë se bëjmë shaka. Por duhet ta dinë që: firma Forever i shpërblen të gjithë ata që punojnë shumë. Edhe me këtë rast përjetuam një eksperiencë të mrekullueshme, morrëm shumë vëmendje dhe surpriza. Jemi krenar që punojmë në një firmë tek e cila kanë besim edhe miqtë tanë. Më lejoni që edhe me këtë rast të falenderojmë gjithë linjën tonë të menaxherëve. Falenderojmë punën e skuadrës pa të cilën nuk do të bëhej i mundur për ne udhëtimi për në Rio de Janeiro. Falenderojmë gjithashtu përfaqësinë sllovene dhe skuadrën hungareze për informacionet e rëndësishme dhe pritjen e ngrohtë.





Rruga fillimisht na çoi në Budapest ku u takuam me pjesëmarrësit e tjerë dhe ku na prisnin hosteset, të cilat na morrën valixhet dhe na siguruan biletat e avionit. Surpriza e parë: bileta të klasit më të lartë. Me bileta të tilla në sallat e pritjes VIP të aeroportit merret shërbim i plotë: ushqim, pije, fruta, gjithçka që na dëshiron syri dhe goja – dhe gjithë kjo all inclusive. Udhëtim në sedilje që mund të bëhet krevat masazhi, me sistem audio dhe video... e papërshkrueshme! Në këtë mënyrë rruga më shumë se dhjetë orë e gjatë s'është aspak e lodhshme...



Ditën e parë udhëtuam deri në Madrid, ku pas një vizite të qytetit hëngrëm darkë në një restorant ku tavolina duhej prenotuar dy javë më parë. Për këtë surprizë falenderojmë në mënyrë të veçantë Attilën dhe gruan e tij, pasi këtu festuam kualifikimin e tyre të profitit. Të nesërmen në një atmosferë të shkëlqyer vazhduam rrugën për në Rio të Brazilit, ku na prisnin me padurim. Drejtuesit e kësaj pjese të botës prezantuan menaxherët më të suksesshëm – faleminderit, Aidan O'Hare!





Brazil
World Rally 2010

The logo features a blue circle with a stylized yellow and green swoosh and a yellow bird in flight. The word 'Brazil' is written in a green, sans-serif font, and 'World Rally 2010' is written in a smaller, brown, sans-serif font below it.



Ditën tjetër vizituam qytetin: nga kodra që ndodhet pranë Rios shfaqet një pamje fantastike e qytetit. Drekën e hëngrëm në një restorant ku mund të zgjidhni ndërmjet njëzet lloj mishrave. Kurse në mbrëmje shijuar plazhin e Cococabanës, pasi hoteli ynë – me pishinë në taracë, shërbim fitness dhe masazhi – ndodhet pranë plazhit.

World Rally që e mezi e prisim na e shtoi akoma më shumë entuziazmin. Drejtori i përgjithshëm ishte në formë fantastike, rreth nesh ndodheshin shumë distributorë të suksesshëm me çeqet e merituar që me raste kishin vlera qiellore prej 500000 USD, me pagesat fantastike të muajit të 13-të, të cilat natyrisht janë meritë edhe e punës së planifikuar në skuadër. Programi i Rallyt zgjati dy ditë, pasi këtu u mbledhën shumë distributorë të suksesshëm të kualifikuar. Në arenë ndihet shpirti dhe forca pozitive e rrezatuar prej turmës.

Dëshiroj të falenderoj në mënyrë të veçantë Dr. Sandor Milesz-in dhe Peter Lenkey-n. Falenderojmë Veronika dhe Stevo Lomjanski-n për përkthimin. Falenderojmë Mikin, Attilën, Adolfn dhe bashkëshortet e tyre për shoqërinë e mrekullueshme. S'jeni rastësisht më të mirët! Faleminderit, faleminderit, faleminderit, Forever Living Products!

TOMO BRUMEC

(Ditarin e udhëtimit e vazhdojmë në numrin e ardhshëm të revistës sonë.)



Të pushojmë dy herë në verë - falas!



Ekzistojnë dy periudha kualifikimi. Të dyja kanë nivel 1 dhe 2. Niveli i parë do të thotë që në krahasim me pozicionin aktual ngjitesh një nivel më lartë (por të paktën në nivelin e Supervizorit) në planin marketing, dhe deri në fund të periudhës së kualifikimit në çdo muaj ke një aktivitet prej 4 pikësh. Është e vërtetë për të dyja periudhat e kualifikimit: niveli i dytë do të thotë që ngrihesh jo vetëm në nivel, por krahas ruajtjes së aktivitetit tënd (4 pikë) në të paktën dy muaj të periudhës së mbetur mbledh aq pikë sa niveli që u ngrite gjatë periudhës së kualifikimit. Përshembull nëse në mars bëhesh Supervizor, atëherë në prill dhe në maj numri i përgjithshëm pikëve të tua duhet të jetë të paktën 25 – ose nëse në qershor bëhesh me 75 pikë, atëherë edhe numri i përgjithshëm i pikëve të korrikut dhe gushtit duhet të jetë 75.

Niveli i parë : Forever anëtarëve të vjetër që dëshirojnë të ngrihen në nivel deri më 31 maj, por kynë hyrë në FLP para 1 shkurtit, në periudhën e kualifikimit që fillon në janar u kërkon aktivitet vetëm nga 1 marsi! Në periudhën e dytë të kualifikimit (nga 1 qershori) rregullat e aktivitetit janë: në rastin e atyre që hyjnë para 1 qershorit kërkohen 4 pikë që nga 1 qershori, kurse për ata që hyjnë pas 1 qershorit që nga muaji i ardhshëm i plotë është i detyrueshëm aktiviteti prej 4 pikësh pavarësisht nga niveli i tyre aktual i biznesit. (Edhe As. Supervizori duhet të bëjë 4 pikë që nga muaji i parë i plotë, edhe nëse nuk kualifikohen në atë muaj si Supervizor.)

Detajet:

I. HOLIDAY RALLY – KAPËRCE NJË NIVEL!

Periudha e kualifikimit: nga 1 janar 2010 deri më 31 maj 2010.

Kush mund të kualifikohet? Çdo distributor i ri dhe i vjetër, i cili në planin Marketing ngjitet në një nivel më të lartë se sa niveli aktual (nga niveli i Distributorit mund të kualifikohesh vetëm me arritjen e nivelit të Supervizorit).

Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit!

Cilat janë kushtet e kualifikimit të këtij programi motivues?

Kapërce një nivel! Gjatë periudhës së kualifikimit tregohu aktiv (blerje me vlerë 4 cc personale, nga të cilat të paktën 1 cc bëhet me kodin personal) që nga muaji i parë i plotë, pra nëse hyn në 15 shkurt 2010, atëherë që nga 1 marsi. Ngjitu një nivel më lart se sa niveli aktual në planin Marketing (ata që ndodhen në nivelin e Distributorit të arrijnë nivelin e Supervizorit). Ky është niveli 1 i Holiday Rally-t.

Pas kualifikimit në nivel më të lartë, deri në fund të periudhës së kualifikimit të Rally-t, në dy muajt që vijjnë më pas mund të arrijnë edhe nivelin 2, pra nëse nga niveli i Distributorit ose Asistent Supervizorit në mars arrin nivelin e Supervizorit, krahas ruajtjes së aktivitetit tënd qarkullimi i marsit dhe i prillit, si dhe i prillit dhe i muajit së bashku duhet të jetë 25 cc! Nëse nisesh nga niveli i Supervizorit dhe në mars arrin nivelin e Asistent Menaxherit, krahas ruajtjes së aktivitetit



FOREVER JEP PËRSËRI MËTEPËR! PARIMI QË SHËRBEËN SI MOTOJA E VITIT 2010, NDRYSHIM (MUDANÇA) E ARRITI NË MËNYRË TË DENJË EDHE HOLIDAY RALLY-N SHUMË TË SUKSESSHËM. FALË PRESIDENT CLUB DHE DR. SANDOR MILESZ TANI FOREVER NA ÇOJNË DY HERË NË DETIN ADRIATIK, NË POREÇ, PËR TË MËSUAR, PUSHUAR DHE ARGËTUAR. TË SHIKOJMË PAK SE ÇFARË PUNE DUHET BËRË PËR TË ARRITUR KËTË ARGËTIM TË SHKËLQYER ME PESË YJE QË BËN FJALË VETËM PËR NE.



tënd qarkullimi i marsit dhe i prillit, si dhe i prillit dhe i muajit së bashku duhet të jetë përsëri 75 cc, dhe kështu mëtej. Nëse e arrin këtë, atëherë kualifikohesh në nivelin 2 të Holiday Rally-t.

Nëse hyn në muajin e fundit të periudhës së kualifikimit dhe i plotëson kushtet e kualifikimit për në Holiday Rally, atëherë në Holiday Rally nuk mund të marrësh shërbim VIP, por natyrisht kualifikohesh në nivelin 1.

Ai që në periudhën e parë ose të dytë të kualifikimit kapërcen dy ose më shumë nivele në sistemin tonë Marketing merr shërbimin VIP në Holiday Rally, pra arrin nivelin 2.

Strehim: në hotele me 4 yje me shërbim all inclusive.

Punonjësit e kualifikuar në nivelin 2 i transportojmë me autobusa VIP në vendin e organizimit të Rally-t, gjatë aktivitetit marrin shërbim VIP në bufe, për ta krijujmë pika shitjesh VIP dhe për ta s'ka qëndrim në radhë.

Punonjësit e kualifikuar në nivelin 1 duhet ta paguajnë vetë udhëtimin, dhe natyrisht me pagesë mund t'i marrin në përdorim shërbimet e firmës sonë.

Kur dhe ku do të organizohet Holiday Rally I?

Në 24, 25, 26, 27 qeshor 2010 në Poreç të Kroacisë.

HOLIDAY RALLY II – KAPËRCE NJË NIVEL!

Periudha e kualifikimit:

nga 1 qershor 2010 deri më 31 gusht 2010.

Kush mund të kualifikohet? Çdo distributor i ri dhe i vjetër, i cili në planin Marketing ngjitet në një nivel më të lartë se sa niveli aktual (nga niveli i Distributorit mund të kualifikohesh vetëm me arritjen e nivelit të Supervizorit).

Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit!

Cilat janë kushtet e kualifikimit të këtij programi motivues?

Kushtet e kualifikimit për në Holiday Rally II janë të njëjta me ato të Holiday Rally I.

Kur dhe ku do të organizohet Holiday Rally I?

Në 30 shtator, në 1, 2, 3 tetor 2010 në Poreç të Kroacisë.

Ju presim dhe ju ripresim në Poreç!

Tibor Radoczki
soaring menaxher



CONQUISTADOR

TOP 10 CLUB

HUNGARIA



1. GÖRBICS ORSOLYA JUDIT
DEMCSÁK L. MIKLÓS
2. DR. NÉMETH ENDRE
LUKÁCSI ÁGNES
3. DR. ROKONAY ADRIENNE
DR. BÁNHEGYI PÉTER
4. VÁRADI ÉVA
5. NAGY ÁDÁM
NAGYNÉ BELÉNYI BRIGITTA
6. DR. SERESNÉ DR. PIRKHOFFER KATALIN
DR. SERES ENDRE
7. FEHÉRVÁRI ANTAL
FEHÉRVÁRINÉ KOVÁCS ZSUZSANNA
8. HEINBACH JÓZSEF
DR. NIKA ERZSÉBET
9. FUTAKI ILDIKÓ
10. VÁGÁSI ARANKA
KOVÁCS ANDRÁS

SERBIA

1. STEVAN LOMJANSKI
VERONIKA LOMJANSKI
2. TATJANA NIKOLAJEVIĆ
BOGDAN NIKOLAJEVIĆ
3. MIODRAG UGRENOVIĆ
OLGA UGRENOVIĆ
4. VLADIMIR JAKUPAK
NEVENKA JAKUPAK
5. ALEKSANDAR RADOVIĆ
DANA RADOVIĆ
6. MILANKA MILOVANOVIĆ
MILISAV MILOVANOVIĆ
7. DR. SONJA JOVIĆ RANĐELOVIĆ
DRAGAN RANĐELOVIĆ
8. BRANISLAV BRAČANOVIĆ
MARIJA BRAČANOVIĆ
9. ZORAN ŠKORIĆ
DRAGICA ŠKORIĆ
10. LEONORA DRAGIĆ
GORAN DRAGIĆ



DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM
TË MUAJIT PRILL 2010 NË
BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT

KROACIA



1. **JADRANKA KRALJIĆ PAVLETIĆ**
NENAD PAVLETIĆ
2. **ZLATKO JUROVIĆ**
SONJA JUROVIĆ
3. **ELVISA ROGIĆ**
JAKOV ROGIĆ
4. **JASMINKA PETROVIĆ**
MIRKO PETROVIĆ
5. **TIHOMIR STILIN**
MAJA STILIN
6. **JASNA KVATERNIK JANKOVIĆ**
IVICA JANKOVIĆ
7. **ANDREA ZANTEV**
8. **NEDELJKO BANIĆ**
ANICA BANIĆ
9. **IVAN LESINGER**
DANICA LESINGER
10. **OKSANA ZVINEKOVA**
ALEKSANDAR ZVINEK

BOSNIA-HERCEGOVINA

1. **ZEČIR CRNČEVIĆ**
SAMIRA CRNČEVIĆ
2. **DŽEVAD DŽAFEROVIĆ**
ALBINA DŽAFEROVIĆ
3. **PRIM. DR. GORAN FRANJIĆ**
4. **ZDRAVKA ILIJIĆ**
5. **DR. NEDIM BAHTIĆ**
BELMA BAHTIĆ
6. **SAVKA VARAJIĆ**
7. **MELIHA DRAGIĆ**
DRAGAN DRAGIĆ
8. **ZORAN NJEGOVIĆ**
9. **SLAVEN KUZMANOVIĆ**
SANJA DIMIĆ
10. **ZORAN VARAJIĆ**
SNEŽANA VARAJIĆ



SLLOVENIA



1. **JOŽEFA ZORE**
2. **DANICA BIGEC**
3. **TOMISLAV BRUMEC**
ANDREJA BRUMEC
4. **PETRA SMILJANIĆ**
MARKO SMILJANIĆ
5. **TANJA JAZBINŠEK**
6. **DAŠA HOFSTÄTTER JAZBAR**
MARKO JAZBAR
7. **STANISLAVA VINŠEK**
8. **KARMEN ŠLIBAR**
9. **LOVRO BRUMEC**
10. **MARJETA KREJČI HRASTAR**
MILAN HRASTAR





NIVELIN E MANAGER-IT E ARRITËN

Szemenyei Ervinné

(Görbics Orsolya Judit & Demcsák L. Miklós)

„Përveç familjes sime dëshiroj të falenderoj sponsorin Miklos L. Demcsak dhe mentorin Miklos Berkics. Të dy më ndihmuan shumë që të arrij deri këtu.”



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Elvisa Rogić & Jakov Rogić
Somogyi Józsefné & Somogyi József



NIVELIN E SUPERVISOR-IT E ARRITËN

Ábrahám Antal
Borsos Ildikó & Borsos Tibor
Buzás Gábor Tamás & Buzásné
Süle Petronella
Bödö György & Bödő Györgyné
Bódi Tibor & Bódiné Lórinca Andrea
Csóka Gábor & Izsák Ilona
Czifrus Péter & Képes Ágnes Jolán
Dobai Anita
Dr. Haraszi Péter & Dr. Harasztné Soós Márta
Zlatko Frankić
Snježana Frankić & Slobodan Frankić
Gerencsér Ibolya Zsuzsanna
& Komáromi Zoltán
Darija Grzinčić & Marino Grzinčić
Göncfalvi Krisztina
Hajnal Szilvia
Hardi Ágnes
Horváth Lászlóné & Horváth László
Huszka Zsolt & Huszka-Seress Katalin
Maksim Ilinčić
Esrefa Kevrić & Hasan Kevrić
Király Csaba Nándorné
Kotán Zoltánné & Kotán Zoltán
Kovács Anita
Antonela Kunda & Ivica Kunda
Nenad Kuzmanović
Nada Kuzmanović & Radoje Kuzmanović

Slaven Kuzmanović & Sanja Dimić
Lazić Jovanka & Lazić Slavko
Magyar József & Magyar-Bánki Zsuzsanna
Mangné Keresztes Beatrix & Mang János
Miletics Éva
Nagy Csaba
Nagy-Székely Hunor
Pasinszky Jánosné
Pelsőci Ildikó
Pivarcsi Melinda
Ruppert Nóra
Dušanka Siljegović & Đorđe Siljegović
Somogyi Zsolt Tamás
Duško Stojanović & Ljiljana Stojanović
Sörös Józsefné & Sörös József
Tollár Tiborné
Vaszary Rita
Zatik Józsefné & Zatik József
Oksana Zvinekova & Aleksandar Zvinek



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1

Bakó Józsefné & Bakó József
Balázs Nikolett
Balogh Anita & Süle Tamás
Bánhidny András
Becz Zoltán & Becz Mónika
Bodnár Daniela

Botka Zoltán & Botka Zoltánné
Czeléné Gergely Zsófia
& Dr. Reindl László
Csepi Ildikó & Kovács Gábor
Csuka György
& dr. Bagoly Ibolya
Csürke Bálint Géza & Csürke Bálintné
Dobsa Attila
& Dobsáné Csáki Mónika
Goran Dragojević & Irena Dragojević
Éliás Tibor
Dr. Farády Zoltán & dr. Farády Zoltánné
Farkas Gáborné & Farkas Gábor
Fittler Diána
Anton Gajdo & Olivia Gajdo
Geczó Éva Krisztina
Geczó László Zsoltné & Geczó László Zsolt
Gecse Andrea
**Görbics Orsolya Judit
& Demcsák L. Miklós**
Haim Józsefné & Haim József
Hajcsik Tünde & Láng András
Halomhegyi Vilmos
Heinbach József & dr. Nika Erzsébet
Hofbauer Rita & Gavalovics Gábor
Illyés Ilona
Jancsik Melinda
Jozó Zsolt & Molnár Judit
Dr. Kálmánchey Albertné
& dr. Kálmánchey Albert
Dr. Kardos Lajos
& dr. Kardosné Hosszú Erzsébet
Kása István & Kása Istvánné
Kemenczei Vince & Tamási Krisztina
Keszlerné Ollós Mária
& Keszler Árpád
Kibédi Ádám & Ótos Emőke
Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Klaj Ágnes



SË BASHKU NË RRUGËN DREJT SUKSESIT

K O S O V A , S E R B I A , M A L I I Z I , S L O V E N I A

Sonja Knežević & Nebojša Knežević
Knisz Péter & Knisz Edit
Kovács Gyuláné
& Kovács Gyula
Köves Márta
Jadranka Kraljić Pavletić
& Nenad Pavletić
Kulcsárné Tasnádi Ilona
& Kulcsár Imre
Lapicz Tibor
& Lapiczné Lenkó Orsolya
Dr. Predrag Lazarević
& dr. Biserka Lazarević
Léránt Károly
& Lérántné Tóth Edina
Lipp Szilvia & Molnár Mihály
Lukács László György
Dr. Lukács Zoltán
& dr. Lukácsné Kiss Erzsébet
Major István
& Majorné Kovács Beatrix
Mayer Péter
Mészáros Istvánné
Branko Mihailović
& Marija Mihailović
Miklós Istvánné & Tasi Sándor
Mirjana Mičić & Vilmoš Harmoš
Mohácsi Viktória
Molnárné Kalcsu Klára
Mrakovics Szilárd & Csordás Emőke
Mussó József & Mussóné Lupsa Erika
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
Nagy Gabriella & Márkus József
Nagy Zoltán & Nagyné Czunas Ágnes
Marija Nakić & Dušan Nakić
Oltvölgyné Zsidai Renáta
Orosz Ilona & dr. Gönczi Zsolt
Orosz Lászlóné
Papp Imre & Péterbenze Anikó
Papp Tibor & Papp Tiborné
Dr. Pavkovics Mária
Radics Tamás & Poreisz Éva
Radóczki Tibor & dr. Gurka Ilona
Ramháb Zoltán & Ramháb Judit
Ráth Gábor
Rezván Pál & Rezvánné Kerek Judit
Róth Zsolt & Róthné Gregin Tímea
Rudics Róbert
& Rudicsné dr. Czinderics Ibolya

Rusák József & Rusák Rozália
Rusák Patrícia
Dr. Steiner Renáta
Dr. Surányi Katalin & Gazdig Sándor
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Sulyok László
& Sulyokné Kőkény Tünde
Szabados Zoltán
& Szabadosné Mikus Emese
Szabó Ildikó
Szabó Péter
Szeghy Mária
Székely János & Juhász Dóra
Széplaki Ferencné
& Széplaki Ferenc
Tanács Erika
Tanács Ferenc
& Tanács Ferencné
Tasnády Beáta & Vörös Zoltán
Téglás Gizella
Térmegei Lászlóné
& Térmegei László
Tordai Endre
& Tordainé Szép Irma
Tóth Tímea
Dr. Dušanka Tumbas
Túri Lajos
& Dobó Zsuzsanna
Miodrag Ugrenović
& Olga Ugrenović
Vareha Mikulas
Varga Zsuzsa
Visnovszky Ramóna & Bognár Gábor
Vitkó László
Jožefa Zore

NIVELI 2

Botis Gizella & Botis Marius
Császár Ibolya Tünde
Dominkó Gabriella
Hertelendy Klára
Dragana Janović
& Miloš Janović
Milanka Milovanović
& Milisav Milovanović
Daniela Ocofoljić
Dr. Marija Ratković
Révész Tünde & Kovács László

Siklós dr. Révész Edit & Siklós Zoltán
Szépné Keszi Éva
& Szép Mihály
Tóth Csaba
Varga Géza
& Vargáné dr. Juronics Ilona

NIVELI 3

Berkics Miklós
Bíró Tamás
& Bíró Diána
Bruckner András
& dr. Samu Terézia
Budai Tamás
& Budai-Schvarcz Éva
Marija Buruš
& Boško Buruš
Fekete Zsolt
& Ruskó Noémi
Halmi István
& Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Juhász Csaba
& Bezzeg Enikő
Dr. Kósa L. Adolf
Krizsó Ágnes
Leveleki Zsolt
& Leveleki Anita
Stevan Lomjanski
& Veronika Lomjanski
Dr. Németh Endre
& Lukácsi Ágnes
Zoran Ocofoljić
Senk Hajnalka
Dr. Seresné dr. Pirkhoffer Katalin
& dr. Seres Endre
Szabó József
& Szabó Józsefné
Tóth István
& Zsiga Márta
Tóth Sándor
& Vanya Edina
Utasi István
& Utasi Anita
Vágási Aranka
& Kovács András
Varga Róbert



Të jetosh ÇDO moment

Për herë të parë e pashë në skenën e Arenës Sportive, përpara mijëra njerëzve në festën aktuale mujore Dita e Suksesit të FLP-s. Ishte i gëzuar dhe i qetë. Por Dr. Sandor Milesz ishte po kaq i qetë dhe i gëzuar edhe gjashtë orë më vonë, ndërkohë që organizonte dhe drejtonte vazhdimisht. Edhe prapa skenës ishte njëlloj si kur shfaqej. Bisedonte i kënaqur dhe dukej qartë që i pëlqente festa. Të gjithë e thërrisnin thjeshtë Sandor. Por vura re që pas emrit „Sandor” fshihesh shumë respekt, dhe publiku e konsideronte të vetin. Disa ditë më vonë e pyes në zyrën e tij:

Sa të rëndësishme janë për ty këto festa të firmës?

Shumë të rëndësishme, pasi në to ndërthurren suksese profesionale dhe personale, takohet krenaria dhe përulja ndaj detyrës. Përpiqemi njëkohësisht t'u japim forca të gjithëve dhe t'i gëzohemi energjisë stimuluese që na jepet. Sukseset tona jo vetëm i radhisim, por edhe i përjetojmë së bashku.

Kjo është detyrë dhe mundësi komplekse në ditët e zakonshme.

Kam shumë detyra, duhet të udhëtoj shumë, është një ndjenjë e mirë të gjesh gjëra të reja, por më pëlqen shumë të bisedoj me njerëzit tanë, të mendoj së bashku me skuadrën tonë. Po, të gëzohemi së bashku, të festoj me të tjerët, kjo është ajo që më pëlqen më shumë nga të gjitha.

Të pash në Ditën e Suksesit.

Në festë njeriu nuk përfaqëson vetëm pozicionin e vet. Unë nuk i mas

kurrë energjitë. Tek ne bëhet fjalë rreth komuniteteve, krenarisë dhe të ardhmes dhjetra vjeçare. Feston jo vetëm mendja, por edhe zemra. Kështu që një moment i tillë na mbush plot me energji të gjithë ne. Duhet t'i bëjmë vend vetes sipas traditave, pasi ne jemi të sigurt që lodhja dhe vështirësitë: janë vetëm kalimtare. Në Forever çdo festë është njëkohësisht llogari dhe triumf për ata që arrijnë rezultate në shitje dhe në botën e tyre.

Në botën e tyre?

Kjo do të thotë që ne e dimë se çfarë punë e madhe qëndron pas një rezultati të arritur, sa duhet të punoj, të zhvillohet dhe sa herë duhet ta mposht dikush vetveten dhe vështirësitë për të arritur këto rezultate. Prandaj meritojnë vlerësim dhe respekt.

Vlerësimi të jep forca?

Në FLP nëse dikush vlerësohet para disa mijëra njerëzve, kjo është diçka shumë serioze, pas të cilës qëndron një punë e madhe. Me këtë rast personi i vlerësuar përgëzohet nga skuadre dhe familja e tij. Për mua momentet më të bukura të suksesit janë kur marr pjesë në krenarinë e „heronjve” të Forever-it.

Mendoj kjo është pjesë e motivimit.

Shumë gjëra mund të kenë forcë motivuese, por krahas materialeve dhe vlerësimit të individit, edhe vëmendja dhe respekti i publikut jep forca të reja. S'është rastësi që tek ne asnjëri nuk këmbëngul për rolin dhe pozitën e tij, e rëndësishme është që krijohet një atmosferë e ngrohtë familjare, që

fëmijët luajnë në skenë pas programit, që presim edhe për minuta me radhë një skuadër kur kërcen nga gëzimi. Tek ne në këtë kohë kjo nuk është strategji biznesi, por mënyrë të menduari dhe jetese.

Ti je drejtori gjeneral, me fjalë të tjera drejtuesi numër një. Dhe është e qartë që ti ke për detyrë dhënien e shembullit.

Dhe përgjegjësi. Jam drejtuesi i FLP-s së Hungarisë dhe rajoneve të saj, ndërkohë që jam pjesë e kësaj familje, ku pikësynimi i të gjithëve është suksesi. Për mua janë të rëndësishëm të gjithë anëtarët e familjes dhe jam krenar për të gjitha rezultatet.

Anëtar i familjes?


Po, ai që është me ne, e ka vendosur që çfarë kërkon nga jeta dhe ku po shkon. Kjo nuk do të thotë vetëm punë, por edhe profesion, ekperiencë dhe fitore. Sigurisht ka edhe rregulla të përbashkëta. Përsa i përket familjes, për mua FLP-ja është vetë jeta. Është më shumë se një punë. Hobi, më tepër një formë jetese. Në mënyrë simbolike, partnerja ime e dytë. E adhuroj familjen time.

A mund ta mbush kaq shumë një profesion jetën e një njeriu?

E mbush dhe e pasuron në çdo aspekt. Unë çdo informacion dhe pikëpamje të re e shikoj edhe në mënyrën se si mund ta shfrytëzoj në botën e Forever-it. Mendoj vazhdimisht për ide dhe rrugëzgjdhje të reja. Suksesi është diçka e mirë, por duhet të kërkojmë gjithmonë rrugë të reja tek produktet

Një vendim për gjithë jetën: Dr. Sandor Milesz në vitin 1997 morri përsipër ndërtimin dhe drejtimin e rajonit të FLP-s me qendër Hungarinë. Një vendim ku luajti rol përgjegjësia, marrja përsipër e detyrave dhe angazhimi për krijimin e vlerave të përbashkëta dhe arritjen e sukseseve.

Sandor sot është drejtuesi i dhjetra mijëra punonjësve dhe i një „skuaadre të madhe” tepër të suksesshme. Punon, drejton, krijon – dhe gëzimin e rezultateve të arritura e ndan me të gjithë ata që janë kolegët e tij në një nga firmat më të suksesshme të botës: në FLP.



dhe në komunikim. Ndjekim me vëmendje tregun dhe planifikojmë me skuadrën tonë.

Kërkesa e zhvillimit të vazhdueshëm?

Ky është çelësi, të zhvillohesh vazhdimisht dhe të jesh gjithmonë një hap përpara të tjerëve, kështu mund të drejtojmë vazhdimisht në treg. Sepse nëse mund të bëhemi më të mirët, atëherë kjo gjë bëhet një kërkesë e natyrshme.

Sa prej kësaj është sfidë personale?

Njëlloj si më parë si kërkues kimist, edhe tani si drejtues kërkoj „substancat” e mira, përbërësit që lidhen me efekt me njëri tjetrin, cilësinë e re. Madje edhe më shumë: jetën e mirë, gjithçka që e sjell këtë. Por jam edhe maniak pas punës, më pëlqen të merrem me njerëzit. Më intereson bërja më me vlerë dhe më e jetueshme e jetës, është e rëndësishme që t’i japim kuptim asaj. Edhe jetës sonë, edhe të atyre që na rrethojnë.

Që të bëhen të suksesshëm në atë që fillojnë?

Kushdo mund të bëhet i suksesshëm, por për këtë nevojitet këmbëngulje.

Duhet aftësi e mirë pune, qëllim i përcaktuar, plane të sakta dhe angazhim. Ne ofrojmë mjete dhe produkte shumë të mira, por secili duhet ta përshkojë vetë rrugën. Nuk mund të punoj tjetër njeri në vend të tij.

Dhe atëherë mund të bierë rehat

Varet se me sa kënaqet. Suksesi nuk do të thotë vetëm para, por edhe pavarësi, realizimin e vetvetes, mundësinë e mbështetjes së familjes, shokëve. Sepse për arritjen e suksesit nevojitet punë, por për shijimin e tij nevojiten edhe shokë. Jeta e pasur ka nevojë për hapje.

Hapja do të thotë edhe ndryshim?

